



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 20, paragrafi 11 të Ligjit nr. 06/L-024, për trajtimin e ndërtimeve pa leje (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 14/20, gusht 2018), nenit 5, paragrafi 5, dhe neni 8 paragrafi 3 të Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 06/2019, për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, të kategorisë I dhe II, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2019, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyrën e caktimit të kësteve.
- II. Nga taksa e ndërtimeve pa leje, do të lirohen pronarët e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe pronarët e ndërtimeve pa leje të kategorisë II, që janë shtëpi, gjegjësisht familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës, ish-të burgosurit politikë, personat me aftësi të kufizuara, si dhe të gjitha kategoritë tjera të liruara sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Lirimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, vlen vetëm për zgjidhjen e çështjes së banimit dhe jo për objekte të cilat janë të destinuara për treg.
- IV. Mënyra e caktimit të kësteve dhe afatit:
 - a) Kategoria I, e cila tejkalon shumë prej tetëqind (800) €, mund të bëhet në dy këste, në afat për 30 ditë.
 - a) Kategoria II, e cila e tejkalon shumë prej dhjetë mijë (10.000) €, mund të bëhet në dy këste, në afat për 60 ditë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-434/01-315027/19, më 30.12.2019

KRYESUESI I KUVENDIT

